

## **Misioni:**

- S.U.T luan një rol aktiv në promovimin dhe përmirësimin e shëndetit, duke i vënë këto në shërbim të pacientit dhe komunitetit përfitues.
- S.U.T implementon dhe aplikon njohuritë dhe teknologjitë më të përparuara mjekësore, duke përmirësuar vazhdimisht performancën institucionale.
- S.U.T merr përsipër të edukojë, arsimojë dhe trajnojë mjekët dhe personelin e ardhshëm mjekësor, në bashkëpunim me universitetet publike dhe private me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi.
- S.U.T ofron një mjedis të favorshëm për pacientët dhe familjarët e tyre, si dhe për stafin, përfshirë edhe personelin aktiv të Forcave të Armatosura.
- S.U.T ofron shërbim mjekësor, kryen depistime, konsultime dhe kontrole periodike, si dhe shërbime të përgjithshme shëndetësore për komunitetin, me fokus parësor trajtimin e traumave në nivel terciar për të gjithë vendin.
- S.U.T është një institucion shëndetësor që ofron shërbim mjekësor cilësor, duke vendosur pacientin në qendër të kujdesit.

## **Detyrat:**

Spitali Universitar i Traumës shërben si Qendër Kombëtare e Traumës me funksion mjekësor, mësimor dhe kërkimor-shkencor. Si institucion i lartë diagnostikues, mjekues dhe shkencor, ai realizon këto përgjegjësi kryesore:

- Ofrimin e shërbimit të urgjencës mjekësore në nivelin më të lartë në rang kombëtar;
- Përkujdesjen shëndetësore për personelin e Forcave të Armatosura me status ushtaraku;
- Dhënien e kontributit me kapacitete shëndetësore në përmbushje të detyrimeve të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s;
- Ofrimin e veprimtarisë akademike, mësimore dhe kërkimore-shkencore në funksion të procesit arsimor dhe kërkimit në fushën e shëndetësisë;
- Studimin dhe standardizimin e protokolleve, kritereve dhe standardeve për trajtimin e traumës.